



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.08.2014, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2180/14, për z. Zoran Rakic – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2180/14, për z. Zoran Rakic – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Rakic, është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik si Anëtar i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe njëkohësisht drejtor në biznesin privat “METOHIJA” D.O.O. dhe pronar i vetëm në biznesin tjetër S.T.R. “TRGOPROMET”.

Ai fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, z. Rakic është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet t'i bëj për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Rakic, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që të shmanget nga ushtrimi i funksioneve të lartpërmendura në bizneset private, dhe ka deklaruar se këtë do ta bëj në kohë sa më të shpejtë.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresat zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 2765/14 dhe DPKI 03 - 2766/14) me të cilat vërtetohet se ai ka autorizuar persona të besueshëm në këto biznese, ashtu siç parashihet me ligj. Me këtë, zyrtari i lartë z. Zoran Rakic, ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni







**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Uskladu sa članom 11.(stav1.1), članom 5(stav 1, tačka 1.5), članom 18(stav10 i 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, kao i sa članom 19(stav11) Pravilnika o Radu Agencije protiv Korupcije, Direktor Agencije protiv Korupcije, dana 15.08.2014 doneo je sledeću

**ODLUKU**

**I. Zatvara se slučaj broj AKK-03-2180/14, za g.Zorana Rakića-Člana Skupštine Opštine Vučitrn(Opštinski Odbornik) , zato što je visoki javni zvaničnik izbegao sukob interesa u kojem se nalazio.**

**II. Slučaj se može obnoviti u svako doba ukoliko se pojavljuju nove okolnosti.**

**O b r a z l o ž e n j e**

**I. Pokrenuti slučaj pod osnovanom sumnjom za Sukob Interesa u Vršanju Javne Funkcije, br. AKK-03-2180/14, za g.Zorana Rakića-Člana Skupštine Opštine Vučitrn, je tretiran po predviđenoj proceduri u Zakonu br.04/L-051 za sprečavanje sukoba interesa u vršenju javnih funkcija.**

U ovom slučaju ,obavljena je istraga o mogućem sukobu interesa, u toku vršenja javne funkcije visokog zvaničnika g.Zorana Rakića-Člana Skupštine Opštine Vučitrn i istovremeno jedini vlasnik u privatnom biznesu S.T.R."TRGOPROMET " I jedini vlasnik u drugom privatnom biznisu"METOHIJA"DOO.

g.Rakiću je prvo upućeno službeno pismo sa obaveštenjem o pokretanju procedure razmatranja stanja sukoba interesa. Zatim je došlo do sastanka g.Rakića sa službenicima Agencije da bi se razjasnilo stanje u kojem se nalazi i gde je preporučeno koje izmene treba obaviti da bi se izbegla situacija sukoba interesa.

g.Rakiću je preporučeno da prestane sa obavljanjem menadžerske funkcije u pomenutim biznisima, I on je izjavio da će ovo završiti na vreme i pod hitno .

U međuvremenu, isti je Agenciji protiv Korupcije dostavio službeni dopis od strane Agencije za Registraciju Biznisa na Kosovu (DPKI 03-2765/14 i DPKI 03-2766/14) kojom se potvrđuje da je on ovlastio lica od poverenja u ovim biznesima, onako kako je zakonom predviđeno. Ovim je ,visoki zvaničnik, g.Zoran Rakić izbegao situaciju sukoba interesa u kojem se nalazio.

II. Uskladu sa članom 18(stav11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može u svako doba obnoviti slučaj kada se pojavljuju nove okolnosti, pa je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja .

Odluka se dostavlja:

- visokom javnom zvaničniku
- direktoru DSK
- odgovornom službeniku

Direktor Agencije protiv Korupcije:

Hasan Preteni

